



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË GRUPIN PUNUES PËR HARTIMIN E KONCEPTIT PËR THEMELIMIN E MUZEUT PËR DOKUMENTIMIN DHE PREZANTIMIN E KRIMEVE TË ISH-JUGOSLLAVISË DHE SERBISË NDAJ SHQIPTARËVË NË KOSOVË

THIRRJA ËSHTË E HAPUR PËR 1 PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE

Me nismën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të krijohet Grupi Punues për hartimin e konceptit për themelimin e Muzeut për dokumentimin dhe prezantimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Grupi Punues ka për detyrë hulumtimin dhe hartimin e konceptit mbi të cilin do të themelohet Muzeu për dokumentim dhe prezantim të krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë. Mandati i Grupit Punues do të përmbyllet pas miratimit të Konceptit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ky Grup punues do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qendrore publike, duke përfshirë Zyrën e Kryeministrit, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentes së Republikës së Kosovës, Ministri, Akademia e Shkencave dhe Arteve, Universiteti i Prishtinës, Institucione publike, shoqatat e dala nga lufta dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Duke pas rëndësinë e këtij procesi dhe arritjes së gjithëpërfshirjes në këtë proces është e domosdoshme dhe luan një rol kyç përfshirja e organizatave të shoqërisë civile të nivelit qendror dhe lokal në proces. Për këtë Sekretariati i CiviKos do të lehtësoj procedurat e përzgjedhjes së organizatave dhe individëve sipas Rregullores së Punës të CiviKos.

Kriteret që OSHC-të që nomiojnë duhet ti plotësojnë:

1. Organizata duhet të jetë aktive më shumë se pesë vite në sektorin e shoqërisë civile;
2. Organizata të ketë aktivitet primar fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore (të dokumentohet më aktivitete specifike);
3. Të jetë aktive në fushën e dokumentimit dhe prezantimit të historisë dhe trashëgimisë kulturore (të dokumentohet më aktivitetet specifike);
4. Të jetë aktive në fushën e promovimit të trashëgimisë kulturore si mjet për kohezion shoqëror;
5. Të jetë aktive në fushën e hulumtimit, dokumentimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore përmes medimeve të ndryshme: të shkruara, platforma interaktive online etj;
7. Të jetë aktive në fushën e promovimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Kriterët që individët e nominuar duhet ti plotësojnë:

- Të ketë pozite menaxhuese në organizatën që e nominon
- Përvojë të dëshmuar në fushën e trashëgimisë kulturore, dokumentimit dhe prezantimit të historisë.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHC-ja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. CV-në e kandidatit/es që organizata e nominon;
2. Certifikatën e regjistrimit të organizatës;
3. Dëshmi rreth misionit dhe përvojës së organizatës (jo më shumë se 1 faqe A4)

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net, ose në zyret e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 14.08.2023, ora 16:00.

SHENIM: Kjo thirrje është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë dhe nuk limitohet në anëtarësinë në Platformën CiviKos.

Në Rast të Procedurave të Votimit

Në rast se kemi më shumë se 1 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidatët që marrin më së shumti vota do të përzgjidhen anëtar të Komitetit Nacional Koordinues.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i MKRS-së do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OSHC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose

personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShc-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i femrave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar.